

REPUBLIKA E KOSOVES-VLADY
GOVERNMENT OF KOSOVO

MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCES DHE E TEKNOLOGJISE
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEKNOLOGIJE
MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE AND TECHNOLOGY
SEKTORI I ARKIVES-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR

Njësia Org. 5
Org. J. Jednitsa
Org. Unit
Nr. I faqeve 2
Br. stranica
No. pages

Nr. Prot. 1280
Broj Prot.
Prot. No.
Data: 09.09.2021
Datum
Date

Prishtëria



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Datë: 09.09.2021
Nr. 5-1280

Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për licencim të BPRAL i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave të nenit 11 paragrafi 3 dhe 4, nenit 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 si dhe në bazë të neneve 5, 6, 7 dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012, për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, ka shqyrtuar kërkesën për licencim dhe rilicencim të BPRAL- kolegji “UBT” nr. 1280 datë 29.07.2021, ka nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Bartësit Privat të Arsimit të Lartë BPrAL/kolegji “UBT”, i vazhdohet licenca për programet e studimit sipas vendimit të AKA, nr. 3031/21 të datës 12.08.2021 me kohëzgjatje në përputhje me vendimin e MASHTI, nr. 6-2728, datë: 27.09.2019, për Qendrën në Prishtinë, si dhe në degën Prizren dhe Ferizaj.
2. BPrAL/kolegji “UBT” “dega në Pejë, licencohet për periudhën 1 vjeçare (deri me datë: 30.09.2022).
2. Vendimi hyn në fuqi më nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të dispozitave ligjore të cekura më lartë dhe duke pasur parasysh kërkesën e kolegjit “UBT” nr.1280 datë 29.07.2021, Komisioni për licencimin e BPrAL-ve i Ministrisë së Arsimit

Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ka shqyrtuar kërkesën për licencim dhe rilicencim të BPrAL-“UBT”, dhe i ka udhëhequr të gjitha procedurat e nevojshme administrative me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe të saktë të kërkesës së këtij institucioni.

Kolegji UBT posedon vendimin me nr. 3031/21 të datës 12.08.2021 për akreditimin e programeve nga AKA.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, komisioni konstaton se në mungesë të dokumentit që kërkohet sipas UA-25/2012, konkretisht nenit 7 pika 2 paragrafi 2.15 kolegji “UBT”-ja ka ofruar një dokument – deklaratë me shkrim me nr. 1280/2 dt 01.09.2021, përmes të cilës institucioni garanton për sigurinë e objekteve për qendrën në Prishtinë/Lagja Kalabria si dhe degët në Prizren dhe Pejë dhe merr përsipër që të përfundoj procesin e legalizimit brenda vitit.

Komisioni në bazë të kësaj, vendosi që institucionit në fjalë t’i jepet licenca në kohëzgjatje njëvjeçare.

Për vazhdimin e licencës për vitin akademik 2022-2023, kolegji “UBT” duhet të përmbush kriteret sipas UA-25/2012 dhe afateve të cekura në deklaratë.

Komisioni duke marrë parasysh faktet e lartcekura, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim juridik: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi, Sekretarit të përgjithshëm të MASHTI.

Vendimi u dërgohet:

1. Sekretarit të përgjithshëm, MASHTI;
2. Arkivit të MASHTI;
3. Parashtruesit të kërkesës;
4. DALSHT;
5. DNJBIA;
6. Inspektoratit të arsimit, MASHTI.


Burim Gashi
Kryetar i Komisionit